



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:260428

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06216190

C-IV-14-1464

Ankuesi

B M Beograd, Serbi.

Projekti për Ndihmë Juridike Falas, Graçanicë

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 23 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ173-0452, datë 31 janar 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 mars 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ173-0452, të datës 31 janar 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 21,000.00 € për periudhën 1999 – 2001 nga likuidimi i NSH “Kombinati i Lëkurë Këpucëve” (*në likuidim*). Ankuesi theksoi se me vendimin në fjalë është refuzuar kërkesa e tij si e pavlefshme dhe se i pakënaqur me vendimin ka ushtruar ankesën e tij me kohë, për shkak të zbatimit jo korrekt të së drejtës materiale, shkeljes së rregullave procedurale, fakteve të vërtetuara në mënyrë jo të duhur dhe të plotë, me rëndësi për marrjen e vendimit në këtë çështje. Ankuesi pohon se organi i shkallës së parë në arsyetimin e vendimit të ankimuar e ka vlerësuar kërkesën si të papranueshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar brenda 3 viteve nga dita kur parashtruesi (kërkuesi) nuk ka marr pagën dhe nuk ka parashtruar kërkesë në gjykatë ose organin tjetër kompetent,

kështu duke zbatuar nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (LPB) (GZ nr. 53 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ankuesi pohoi se veprimet e organit të shkallës së parë në procesin e konstatimit të gjendjes faktike përkatëse dhe të gjitha fakteve me rëndësi për vendimmarrjen në këtë çështje administrative janë kryer me lëshime elementare dhe kanë cenuar rëndë parimet bazë të sigurisë juridike si dhe të drejtën e kërkuesit për qasje në drejtësi dhe vendim të arsyetuar gjyqësor, në një gjykim në afat të arsyeshëm dhe në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej: KEDNJ) për gëzimin paqësor të pronës në përputhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, pastaj ndalimin e diskriminimit në përputhje me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës d.m.th nenin 14 të KEDNJ. Ankuesi më tej pohoi se është i njohur fakti se ai u detyrua të largohet nga Peja në qershor të vitit 1999 për shkak të rrethanave të njohura përgjithësisht shoqërore dhe politike dhe se largimi i tij nga vendi i punës ishte për shkak të shkeljes së rëndë të sigurisë dmth forcë madhore dhe jo për shkak të veprimeve të tij arbitrare. Ankuesi më tej i referohet dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Punën e Bashkuar për procedurën dhe parimet e vlerësimit të së vërtetës materiale dhe mënyrës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ankuesi thekson se me të drejtë beson se organi i shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili rregullon statusin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit dhe lehtëson qasjen në kthimin e pronës dhe sendeve personale dhe duke marr parasysh se ai si person i zhvendosur brenda vendit i cili nuk jeton në territorin e Kosovës, nuk është në pozitë të njëjtë me qytetarët e tjerë, prandaj është e nevojshme që të i mundësohet ushtrimi i të drejtave elementare të njeriut në një shoqëri demokratike. Gjithashtu, ankuesi beson se veprimet e pakujdesshme të autoritetit kompetent kanë rezultuar në shkeljen e të drejtës për gëzim të qetë të pronës së garantuar me nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, duke qenë se zbatimi i këtij neni nuk kufizohet vetëm në pronësinë e të mirave fizike, por edhe të drejta apo interesa të tjera mund të trajtohen si të drejta pronësore dhe në përputhje me praktikën gjyqësore në fuqi të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Koncepti i pronës në jurisprudencën e GJEDNJ mbulon një gamë të gjerë interesash që kanë vlerë ekonomike, prandaj ka një kuptim autonom që nuk kufizohet në posedimin e të mirave materiale por përfshin edhe të drejta të tjera, pretendime dhe interesa dhe nuk mbështetet, mbi konceptin teknik ligjor të pronës (Gasus Dossier- und Fordertechnik GmbH kundër Holandës, Kërkesa nr.1537/89, Aktgjykimi i 23 shkurt 1995, paragrafi 53). Nën mbrojtje sipas nenit 1 Protokollit 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut konsiderohet se e luajtshme ose e paluajtshme, interesa materiale ose jo materiale, si aksionet, patentat, borxhet dhe pretendimet etj. Në rastin konkret, ekziston një pritje legjitime për pretendimet e pagave të papaguara mbi të cilat ankuesi mund të kishte fituar gëzim efektiv të së drejtës së pronësisë, e cila mungonte për shkaqe objektive dhe jo për fajin e tij. Ankuesi i propozon gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, të marr vendim me të cilin anulohet vendimi i AKP-së dhe lëndën t'ia kthej AKP-së për rivendosje, ose të marr vendim në lidhje me kërkesën e tij për kompensimin e pagave të papaguara në shumë të përgjithshme prej 21,000.00 €, nga të ardhurat e likuidimit të NSH-së. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkëngjitur vendimin e kundërshtuar dhe dëshmitë në kopje si: Kërkesën për lirim nga taksat, Librezën e

punës, Dëshminë (kartën e legjitimit) që jeton si person i zhvendosur si dhe një dëshmi pagese të pensionit të pleqërisë për periudhën 26 janar – 25 shkurt 2014.

Me 26 janar 2024, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, Neni 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr. 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të nenit 74.2 të Ligjit nr. 06/L-086, ankesa në fjalë është e pabazuar. Gjithashtu, parashtruesi ka dështuar të ofroj ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës së tij dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 35.2.4 të Shtojcës së Ligjit nr. 06/L-086, i cili parashikon që një *“ankesë duhet të përmbaj [...] argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet ankesa”*. E paditura më tej thekson se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 dhe 37.4.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ankuesi në ankesë thekson se kërkon paga nga viti 1999 deri në hyrjen e NSH-së në likuidim. Prandaj, në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme, kërkesa konsiderohet e parashkruar tre vjet pas kësaj date. E paditura më tej thekson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, në përputhje me qëndrimin e vet ankuesit i cili thekson se nuk ka punuar për NSH-në që nga viti 1999, pasi është larguar nga Kosova që nga viti 1999 dhe këtu kërkon kompensimin e pagave që nuk i ka realizuar gjatë kësaj periudhe, pra nga viti 1999 deri në hyrjen e NSH-së në likuidim. Si rrjedhojë pretendimet e tij për t'u kompensuar për një periudhë kohe që nuk ka ofruar shërbime pune janë tërësisht të pabazuara. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit se i është shkelur e drejta pronësore, e përcaktuar me GJEDNJ, pala kundërshtare pretendon se rasti i cituar nga ankuesi Gassus Dossier dhe Fördertechnik gmbh kundër Holandës nr. i lëndës 15375/89, i referohet një shoqërie që ka shitur pronën e caktuar, por ka ruajtur të drejtën e pronësisë deri në pagesën e plotë të çmimit. E paditura më tej i referohet rasteve nga jurisprudenca e GJEDNJ sipas të cilave theksohet se qëllimi i parashkrimit është të inkurajoj parashtruesit të veprojnë brenda një periudhe të arsyeshme kohore, të ruajnë sigurinë juridike dhe të parandalojnë që raste jashtëzakonisht të vjetra të rëndojnë gjykatat. Loncar kundër Bosnjës dhe Hercegovinës (ankesa nr. 15835/08), Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës, nr. 38366/97. Së fundmi, për sa i përket pretendimit se ankuesi është diskriminuar për shkak të kombësisë serbe, e paditura mban qëndrimin se ky pretendim është plotësisht i pabazuar, për arsye se parashkrimi i kërkesës për kompensim të pagave të papaguara në përputhje me nenin 608 të LPB (GZ 53/1976) është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë ndaj të gjitha kërkesave të parashtruara nga ana e punëtorëve të NSH-së tek cilido AL, pa marr parasysh përkatësinë etnike, moshën apo gjininë. Zbatimi i afateve të parashkrimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankuesit është një kusht të

cilin AL duhet të përmbush sipas ligjit, përkatësisht nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 dhe kjo dispozitë nuk lë vend për interpretim, pa marr parasysh përkatësinë etnike ose kombëtare të parashtruesit të kërkesës. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4. të Ligjit nr. 06/L-086.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PEJ173-0452, datë 31 janar 2014, me të cilin vendim i ishte refuzuar si e pavlefshme / e parashkruar kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 21,000.00 € për periudhën 1999 – 2001 apo deri në likuidim të NSH “Kombinati i Lëkurë Këpucëve” (*në likuidim*).

Gjykata konstaton se, ankuesi në ankesën e tij kundër vendimit të kundërshtuar me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për paga të papaguara si e parashkruar vetëm i është referuar periudhës kohore prej vitit 1999 – 2001 apo nga të ardhurat e likuidimit të NSH-së, përderisa bazuar në pretendimet e tij ankimore edhe vet ka deklaruar se për shkak të rrethanave të krijuara nuk ka mundur të paraqitet në vendin e tij të punës, pasi në qershor të vitit 1999 e kishte lëshuar Pejën dhe është zhvendosur në Serbi. Prandaj, i njëjti me asnjë dëshmi nuk mbështet pretendimet e tij për paga të papaguara për periudhën kohore objekt kontesti. Për më tepër, siç mund të konstatohet nga

shkresat e lëndës, ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante as në procedurën e likuidimit tek AL, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij në lidhje pagat e papaguara si dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shumën e as lidhur me llogaritjen e pagave, e as për periudhën kohore për pagat e kërkuara përveç një shume të përgjithshme për peridhën kohore 1999 – 2001, apo deri në likuidim, nga të hyrat e likuidimit.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij për kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti në kuptim të respektimit të parimeve të qasjes në drejtësi, në mbrojtje të pronës dhe ligjshmërisë si dhe pritjeve të tij legjitime në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollit 1 të Nenit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe përcaktimeve për respektimin e të drejtave të njeriut si në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por gjen se të njëjtat janë pretendime përgjithësuëse dhe nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe, përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti, prandaj si të tilla edhe refuzohen.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Gjykata ka shqyrtuar kërkesën e ankuesit për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore (pasi i njëjti jeton si person i zhvendosur) dhe në bazë të dëshmive të dorëzuara për gjendjen e tij ekonomike, ka vendosur që të njëjtën ta aprovoj, andaj si rrjedhojë ankuesi nuk do të ngarkohet me taksë gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar